



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT TË KOMPANISË PËR MENAXHIMIN E  
DEPONIVE TË KOSOVËS SH.A  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës sh.a në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshme Arvita Zyferi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi dhe anëtarja e ekipit Valbona Pllana, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	11
4 Qeverisja e mirë .....	26
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve .....	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA.....	34
Shtojca II: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	37

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) për vitin 2018, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i KMDK-së.

### Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

#### **Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes**

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.


#### **Theksimi i çështjes**

Si Theksim të Çështjes dëshirojmë të përmendim faktin se të hyrat tjera në shumë prej 607,882€, dhe tatimi në fitim i prezentuar në shumë 23,575€, nuk ishin shpalosur fare në shënimet shpjeguese. Po ashtu tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin që kompania nuk kishte arritur të siguroi vazhdimin e licencën për administrimin e mbeturinave dhe sigurimin e tariforës për deponimin e mbeturianve.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Kryesuesi i Bordit nuk është pajtuar me disa nga gjetjet dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Kryesuesit të Bordit për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar, janë dhënë në detaje në Shtojcën II.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ndërmarrjes Publike Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e KMDK-së, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (më tutje AP-së).

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (më tutje PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë të përgatitur dhe nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE), dhe të njëjtat dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale të KMDK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit akreal të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

#### Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Prezantimi i të hyrave tjera në kuadër të pasqyrës së të ardhurave në shumë prej 607,882€, nuk është shpalosur në shënimin 11.2 aty ku do të jepen detajet e kësaj të hyre, si dhe në lidhje me tatimin në fitim në shumë prej 23,575€, përkundër deklaratës se ofruar nuk kemi gjetur se në shënimet shpjeguese është shpalosur;
- Nuk është siguruar vazhdimi i licencës për administrimin e mbeturinave. KMDK menaxhon Deponitë e Mbeturinave në rreth 70% të territorit të Kosovës. Ligji për Mbeturina nr. 04/L-60 (neni 16 pika 1), kërkon “Mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave e bënë vetëm personi i licencuar”. Edhe përkundër përpjekjeve për sigurimin e licencës (dhe rekomandimit tonë nga viti paraprak), kompania ende vazhdon të operoj me licencë të përkohshme prej vitit 2012, për shkak të mos përgjigjes nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe
- Nuk është siguruar tariforja e re për deponimin e mbeturinave. Ligji për Mbeturina nr. 04/L-60 neni 14 pika 2, thotë, “Në bazë të dispozitave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe këtij ligji, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në marrëveshje me komunat përkatëse përcakton tarifën për deponimin e mbeturinave komunale në deponitë e caktuara”. KMDK nuk kishte arritur të siguroj tariforen sipas kësaj kërkesë dhe ende vazhdon që shërbimet e veta t’i faturoj në bazë të tarifores së trashëguar nga ZRRUM<sup>1</sup> të vitit 2012. Kjo tarifore (e skaduar) mbulon vetëm mbledhjen e mbeturinave të amvisërisë me vlerë 5.31€/ton. Kompania vazhdon të pranojë lloje tjera të mbeturinave për të cilat nuk kishte licence as tarifore, siç janë: deponimin e qelqit, gomës, mbeturinat e dheut dhe gurëve, mbetje shtazore dhe asgjësimin e mbeturinave të doganës. Për këto lloje të mbeturinave, Bordi i Drejtorëve të kompanisë në janar të vitit 2016 kishte caktuar tarifën në vlerë prej 50€/ton. Këtë veprim kompania e kishte bërë për shkak të mos përgjigjes nga organi kompetent për caktimin e tarifave, respektivisht MZHE.

Rastet e lartcekura nuk e kanë modifikuar opinionin por kanë ndikuar në Theksimin e Çështjes në Opinionin e vitit 2018.

## Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit aktual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjeve të Kosovës, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

---

<sup>1</sup> ZRRUM - Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Mbeturinave.



Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP-së.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## **2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim**

Nga NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L- 42 për Prokurimin Publik (me plotësime dhe ndryshime ); dhe
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore.

- Nga NP, po ashtu kërkohet të përmbush edhe kërkesat si në vijim:
  - Statutin e NP-së;
  - Planin e Biznesit;
  - Raportet tremujore;
  - Raportet vjetore;
  - Raportin për matjen e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
  - Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, deklaratat e bëra nga KE dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Bordin e Drejtoreve mund të konsiderohen të sakta. Përveç çështjeve të lartë përmendura, PFV-të paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi C1**<sup>2</sup> Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se shënimet shpjeguese përfshijnë sqarimet e nevojshme lidhur me të hyrat e prezantuara në pasqyrën e të ardhurave dhe mbi bazën e kalkulimit të tatimit në fitim.

**Rekomandimi A1** Kryesuesi i Bordit duhet të marrë masat e nevojshme për sigurimin e licencës për kryerjen e aktiviteteve të saj primare.

**Rekomandimi A2** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se ka bërë përpjekjet maksimale për të siguruar tariforen e re për deponimin e mbeturinave në mënyrë që të shmangen aplikimet e tarifave pa bazë ligjore.

**Rekomandimi C2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë identifikuar shkaqet për Theksim të Çështjes në Opinion dhe do të marrë masat e nevojshme për eliminimin e tyre. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.

---

<sup>2</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja;  
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura;  
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në KMDK. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së kompanisë që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare por edhe për të siguruar që këto vendime janë adekuate dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmes përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Në kuadër të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsinë e pagesave dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi dhe realizimi i buxhetit, ndërprerja e marrëveshjeve me Kompanitë Rajonale të Mbeturave (KRM) për furnizim me karburante, si dhe rishikimi i Rregullores për menaxhimin e automjeteve.

#### 3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2018 (në €)**

Përshkrimi	Planifikim i fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	1,708,210	1,688,210 <sup>3</sup>	1,636,278	1,557,553
Të hyrat nga subvencionet	0	0	0	114,583
Të hyrat nga grantet e shtyra	566,463	452,996	452,996	463,344
Të hyra tjera	20,000	180,000	607,882	71,034
Të hyra nga interesi	0	0	63,342	0
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>2,294,673</b>	<b>2,321,206</b>	<b>2,307,502</b>	<b>2,206,514</b>

<sup>3</sup> Të hyrat nga shitja/shërbimet janë përfshirë: të hyrat nga KRM-të në shumë 1,398,138€, të hyrat nga klientët privat 215,072€, të hyrat nga mbetjet shtazore 75,000€, të hyrat tjera 180,000€.

Shpenzimet për paga	858,081	858,081	761,667	705,346
Shpenzimet operative	764,750	793,750	772,397	694,598
Shpenzimet e zhvlerësimit	660,568	605,000	612,848	595,878
Shpenzimet e interesit	0	0	70,728	0
Investimet kapitale	481,785	708,235	523,081	0
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>2,283,399</b>	<b>2,256,831</b>	<b>2,137,912</b>	<b>1,995,822</b>

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Plani përfundimtar i të hyrave totale ishte për 26,533€ më i lartë se sa plani fillestar. Bordi i drejtorëve ka miratuar planin e rishikuar të biznesit duke u bazuar në ndryshimet të cilat i ka bërë grupi punues i caktuar me vendimin nr. 36/2018 dhe me datën 06.07.2018 kanë prezantuar ndryshimet dhe plotësimet e planit fillestar të biznesit tek bordi i drejtorëve i cili pas analizës dhe diskutimeve ka miratuar këtë plan me datën 25.07.2018;
- Të hyrat tjera janë rritur në 180,000€ deri sa me plan fillestar ishin paraparë vetëm 20,000€. Rritja ishte rezultat i procedurave dhe vendimeve të përmbaruesve në favor të KMDK-së;
- Shpenzimet operative me planin e rishikuar kanë shënuar një rritje prej 29,000€ krahasuar me planin fillestar. Ky ndryshim ka të bëjë me rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës në shumë 25,000€, shpenzimeve të konsultimeve, trajnimeve, udhëtimeve 3,000€, rritje e shpenzimeve të përfaqësimit në shumë 6,000€ si dhe një ulje të shpenzimeve të administratës për 5,000€. Në tërësi shpenzimet operative janë realizuar në nivelin 97%; dhe
- Shpenzimet për aktivitete investuese krahasuar me planin final të biznesit kanë pasur një rritje prej 226,450€ ku në planin fillestar ishte paraparë vlera prej 481,785€ ndërsa me plan final janë paraparë të realizohen 708,235€. Pavarësisht kësaj, realizimi i planit ishte 74%.

### Çështja 3 - Realizimi jo në nivelin e pritur për investime kapitale

- Gjetja** Qëllimi i planit të biznesit në përgjithësi është arritja e synimeve të kompanisë sipas prioriteteve të saj. Sipas analizave të buxhetit, realizimi i të hyrave në raport me planin e rishikuar të biznesit ishte 99%, ndërsa realizimi i shpenzimeve totale ishte 95%. Mirëpo, investimet kapitale ishin realizuar vetëm 74% nga buxheti i paraparë. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk është bërë një analizë e burimeve të cilat kompania do t'i financoj për 10 projektet e parapara për vitin 2018.
- Rreziku** Realizim jo i duhur i buxhetit, sidomos për investimet kapitale, mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të kompanisë. Ndërsa mungesa e informatave lidhur me burimet e financimit mund të rezultojë që projektet kapitale të mbesin të pa realizueshme dhe kompania të ketë vështirësi të kryej aktivitetet e saj.
- Rekomandimi A3** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e rishikimit të planit të biznesit, të bëhen analiza më të sakta lidhur me mundësitë për realizimin e aktivitet investuese përkatësisht projekteve kapitale. Po ashtu të siguroj se për projektet kapitale të planifikuara, të merrem parasysh burimet e sigurta të financimit.

## 3.2 Pasqyra e pozitës financiare

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrës së pozitës financiare, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

**Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare (Balanci i Gjendjes<sup>4</sup>) i kompanisë më 31.12.2018 (në €)**

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017
Objektet ndërtimore	1,524,036	1,703,951
Pajisjet dhe makineritë	834,942	744,794
Stoqet	18,806	23,306
Llogaritë e arkëtueshme	705,702	916,905
Paraja në bankë dhe arkë	15,335	67,655
<b>Gjithsej Pasuritë</b>	<b>3,098,821</b>	<b>3,456,611</b>
<b>Ekuiteti</b>		
Kapitali themelor	25,000	25,000
Rezervat e rivlerësimit	1,440,299	1,440,299
Fitimet/Humbjet e mbajtura	(89,693)	(277,041)
Fitimet/Humbjet e vitit	137,015	187,348
<b>Detyrimet</b>		
Detyrimet afatgjata (të hyrat e shtyra nga Grantet, Donacionet)	1,140,340	1,593,336
Llogaritë e pagueshme tregtare	365,526	292,924
Llogarit e pagueshme tjera	0	3,044
Obligime për tatime dhe kontribute	79,842	191,701
Obligimet tjera afatshkurta	492	0
<b>Gjithsejtë Detyrimet dhe Ekuiteti</b>	<b>3,098,821</b>	<b>3,456,611</b>

<sup>4</sup> Kompania në PFV e ka emërtuar "Balanci i Gjendjes" derisa SNK-të termin "Balanc i Gjendjes" e kanë ndryshuar dhe emërtuar "Pasqyra e Pozitës Financiare" edhe ne për të qenë në pajtim me SNK e kemi emërtuar Pasqyra e Pozitës Financiare.

---

**Çështja A4 - Regjistrimi i gabuar i shpenzimeve të parapaguara**

- Gjetja** Sipas parimit akrual të kontabilitetit efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike tjera duhet të njihen në momentin e ndodhjes dhe ato duhet të regjistrohen në regjistrat e kontabilitetit dhe raportohen në pasqyrat financiare në periudhën të cilës i takojnë. Me rastin e rishikimit të llogarisë së shpenzimeve kemi gjetur se shpenzimet e parapaguara për sigurimin e automjeteve janë regjistruar si shpenzime të sigurimit në shumë totale prej 3,342€. Prej kësaj shume vetëm 2,446€ është shpenzim i periudhës, ndërsa pjesa tjetër prej 896€ është parapagim dhe do duhej të regjistrohej në bilancin e gjendjes si pasuri qarkulluese. Regjistrimi i gabuar i shpenzimeve të parapaguara të automjeteve ka ndodhur për shkak të interpretimit të gabuar të SNK 1 nga zyrtarët financiar të cilët e kanë konsideruar gabimisht tërë transaksionin si shpenzim të periudhës.
- Rreziku** Regjistrimi i parapagimeve në kategorinë e shpenzimeve ndikon në mbivlerësimin e shpenzimeve dhe nënvlerësimin e parapagimeve të periudhës.
- Rekomandimi A4** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroi që zyra e financave bën regjistrimin e të gjitha transaksioneve në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit, dhe të siguroj se është bërë prerja/regjistrimi i shpenzimeve apo të hyrave të cilat i takojnë vetëm periudhës kontabël.

**Çështja A5 - Mos përsëritja e konkursit derisa nuk ishin plotësuar kërkesat e procedurave të rekrutimit**

- Gjetja** Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të rekrutimit, neni 6, pika 5.1 parasheh se konkursi duhet të përsëritet nëse së paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs. Konkursi i shpallur me datën 19.12.2017 për pozitën Zyrtar për kontrolle të brendshme/kontrollor nuk është përsëritur ndonëse asnjë nga tre (3) kandidatët konkurrues nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit. Pavarësisht kësaj, komisioni ka vazhduar me procesin duke e vlerësuar dhe përzgjedhur njërin si më të suksesshëm.
- Rreziku** Mos përsëritja e konkursit siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ mund të ndikoj në parregullsi gjatë procesit të rekrutimit dhe rasti i tillë mund të rezultojë në konkurrencë të padrejtë, jo transparencë si dhe mos punësim të personelit adekuat.
- Rekomandimi A5** Kryesuesi i Bordit të siguroj që përzgjedhja dhe rekrutimi i kandidatëve të bëhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e rekrutimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara për përsëritje të konkursit dhe respektim të Udhëzimit Administrativ. Gjithashtu të siguroj se caktimi dhe zbatimi i kriterëve ka për qëllim rekrutim transparent të kandidateve duke u bazuar në parimin e meritës dhe kualifikimeve përkatëse për pozitën e caktuar.



---

**Çështja A6 - Bonuse për Drejtorët e Bordit jo në pajtim me vendimin e Aksionarit**

- Gjetja** Sipas vendimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) nr. 01/2599 të datës 18.12.2017, pika 1, ka paraparë, "Pezullimin e vendimeve për kompensimin për stimulimin e efektshmërisë së anëtarëve të Bordeve të Drejtoreve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore". Pavarësisht, kësaj me datën 11.06.2018, Bordi i Drejtorëve të kompanisë ka marrë vendim që tu paguaj kompensimin për stimulimin e performancës vjetore Drejtorëve të Bordit të KMDK-se në lartësi prej 50% të shumës së përgjithshme vjetore të honorarit themelor të përcaktuar me vendimin e Aksionarit. Shuma e paguar për këtë qëllim ishte gjithsej 12,300€. KMDK këtë vendim e kishte bazuar në performancën vjetore të kompanisë me fitimin neto të vitit 2017 prej 187,348€, ndërkohë që raporti i auditorit për vitin 2017 ishte i kualifikuar me theksim të çështjes. Megjithatë, ky fitim nuk është vetëm rezultat i të hyrave nga shërbimet e kompanisë por një pjesë të tij e kanë ndikuar edhe të hyrat nga grantet dhe subvencionet në shumë prej 648,961€. Kjo ka ndodhur sipas zyrtarëve të Kompanisë për shkak se menaxhmenti i KMDK-së ka keqinterpretuar vendimin e aksionarit për pezullimin e vendimeve për kompensime dhe stimule të efektshmerisë së anëtarëve të Bordeve të Drejtoreve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.
- Rreziku** Mos përfillja e vendimit të MZHE-së (në cilësi të Aksionarit) për pezullim të vendimeve për kompensim për stimule ka rezultuar me pagesë jo të rregullt dhe në kundërshtim me vendimin e Aksionarit.
- Rekomandimi A6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se nuk do të merren vendime të cilat nuk janë të ligjshme dhe në pajtim me vendimet e aksionarit. Vendimet e aksionarit duhet të merren parasysh, të vlerësohen dhe të kuptohen si të zbatueshme, ndërsa në rast të paqartësive të kërkohet sqarimi nga Aksionari.

### 3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Ndërmarrja publike KMDK në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave dhe të gjitha shpenzimet që ka krijuar gjatë vitit, si dhe rezultatit financiar.

**Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2018** (në €)

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	1,636,278	1,557,553
Të hyrat tjera	671,224	648,961
<b>Gjithsej të Hyrat</b>	<b>2,307,502</b>	<b>2,206,514</b>
Pagat dhe mëditjet	761,667	705,346
Shpenzimet e stoqeve	4,500	
Shpenzimet e zhvlerësimit	612,848	595,879
Shpenzimet tjera operative	676,674	694,598
Shpenzimet tjera afariste	20,495	-
Të dalat financiare	70,728	
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>2,146,912</b>	<b>1,995,823</b>
Fitimi para tatimit	160,590	210,691
Tatimi në fitim	(23,575)	(23,343)
<b>Fitimi /Humbja neto</b>	<b>137,015</b>	<b>187,348</b>

---

**Çështja A7 - Mos pagesa me kohë e obligimeve tatimore**

- Gjetja** Ligji Nr. 05/L -029 për të ardhurat e korporatave, neni 38, pika 1 thotë: secili tatimpagues çdo tre (3) muaj bënë pagesat e tatimit si paradhënie në llogarinë e caktuar nga ATK-ja në bankën apo institucionin financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës deri më datat 15 prill, 15 korrik, 15 tetor dhe 15 janar për tremujorin kalendarik që u paraprin menjëherë këtyre datave. Po ashtu pika 7 e nenit 38, thotë se nëse pagesa paradhënie nuk është bërë me kohë apo është bërë në shumën që është më pak se ajo e kërkuar, ATK-ja aplikon një ndëshkim në një shumë të barabartë me shkallën e interesit që është në fuqi në kohën kur pagesa paradhënie ka qenë obligative për t'u bërë. KMDK nuk ka respektuar afatet e pagesës së tatimeve. Më datën 31.12.2018 sipas dokumentit të ofruar nga kompania shihet se ka borxh ndaj ATK-se shumën prej 79,792€, duke përfshirë këtu interesin e llogaritur prej 38,775€ dhe ndëshkimet në shumë prej 30,397€. Më datën 31.12.2018 është lidhur marrëveshje në mes KMDK-së dhe ATK-së për pagesat e borxhit me 13 këste pasi kompania nuk ka pasur mjete të mjaftueshme në fund të vitit.
- Rreziku** Vonesat në likuidimin e borxheve të kompanisë ndaj ATK-së mund të rezultojnë me aplikimin e interesit dhe ndëshkimeve duke shkaktuar obligime dhe shpenzime shtesë për kompaninë.
- Rekomandimi A7** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se tatimet dhe kontributet ndaj ATK-së do të paguhet në afatin e caktuar me ligj dhe mos të lejojnë vonesa të cilat shkaktojnë detyrime shtesë për ndëshkime dhe interesa, duke e dëmtuar buxhetin e kompanisë.

**Çështja A8 - Furnizim me derivate të naftës nga KRM "Pastërtia" dhe mungesë e dokumentacionit të plotë lidhur me furnizimin**

**Gjetja** KMDK duhet të furnizohet me derivate të naftës me operator ekonomik të licencuar për atë shërbim dhe sipas kushteve të përcaktuara me kontratë. Më datën 24.05.2018, KMDK ka pranuar faturën në shumë prej 24,184€ për furnizim me naftë për muajt: shtator 3,680 litra, tetor 4,400 litra, nëntor 5,447 litra dhe dhjetor 1,400 litra në vitin 2012 si dhe për muajin janar të vitit 2013 në sasi 3,200 litra, nga KRM "Pastërtia" Ferizaj, ku çmimi mesatar për litër sipas përlllogaritjes sonë, është 1.33€ për litër. Nuk kemi gjetur ndonjë arsyeje të vonesës së faturimit prej vitit 2012 deri në vitin 2018. Dokumentacioni i ofruar nuk ka të bashkangjitur fletë dërgesat për furnizimin me derivate të naftës në kohën kur është furnizuar KMDK, po ashtu ky furnizim ishte bërë nga kompania e cila nuk është e licencuar për shitjen e derivateve të naftës. Sipas KMDK-së deri te furnizimi me derivate të naftës nga KRM "Pastërtia" ka ardhur për shkak se KMDK ka pasur borxhe të larta financiare ndaj operatorit ekonomik në atë kohë dhe OE ka refuzuar të bëjë furnizimin e rregullt me derivate të naftës në stacionin e deponisë në Ferizaj. Rrjedhimisht, KMDK është detyruar të bëjë zgjidhje të shpejtë në mënyrë që të mos ngecë aktiviteti kryesor operativ.

**Rreziku** Furnizimi me derivate të naftës nga kompania që nuk e ka për veprimtari shitjen e karburanteve, paraqet rrezik në pranimin e sasisë dhe cilësisë jo sipas standardeve dhe çmimeve të tregut.

**Rekomandimi A8** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se furnizimi me naftë bëhet vetëm me Operatorin Ekonomik të kontraktuar dhe që ka licencë për shitjen e naftës. Po ashtu duhet të siguroj se zyrtarët financiar mbajnë evidencë dhe raportojnë/shpalosin të gjitha obligimet për të cilat janë pranuar shërbimet apo furnizimet edhe atëherë kur fatura ende nuk ka arritur për ekzekutim.

---

**Çështja A9 - Furnizime me derivate të naftës bazuar në memorandum të mirëkuptimit me KRM Ecohigjiena**

- Gjetja** Memorandumi i mirëkuptimit Nr. 395/13 i datës 08.05.2013 në mes KMDK-së dhe KRM "Ecohigjiena", neni 3 pika 2 thekson se Ecohigjina - Gjilan kur të paraqitet nevoja do t'i ofroj KMDK-së të gjitha shërbimet e mundshme si furnizim me naftë, ndihmë përmes asistimit me makineri etj. Më datën 08.02.2018, KMDK ka pranuar një faturë në shumë prej 8,155€, në të cilën përshkruhen tre artikuj "shërbime sipas kontratës" për 49 njësi në shumë totale prej 8,155€, ndërsa nga analizimi i dokumenteve tjera të ndërlidhura me këtë faturë shihet se Kompania është furnizuar me derivate të naftës. Sipas raportit për pranim të mallit (që është bërë nga komisioni me datën 05.02.2018) dhe fletë dërgesave, kjo faturë ka të bëjnë me furnizim me 3,500 litra naftë për deponinë sanitare në Gjilan dhe 4,000 litra naftë për deponinë sanitare në Prishtinë (çmimi 1.08€/litër). KRM Ecohigjiena nuk është e licencuar për shitjen e naftës si dhe në veprimtarinë e vet nuk e ka shitjen e naftës. Nuk dihen shkaqet e furnizimit me naftë nga KRM Ecohigjiena për këto dy deponi sanitare, përderisa KMDK ka kontrate valide nga dhjetori 2017 me një OE për furnizim me naftë për nevojat e veta me çmim prej 1.02€/litër.
- Rreziku** Furnizimi me derivate të naftës nga KRM Ecohigjiena mund të rezultojë në pagesën e çmimeve më të larta se sa çmimi i tregut dhe mundësi manipulimi nga të dy palët e përfshira.
- Rekomandimi A9** Kryesuesi i Bordit duhet të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës përse janë pranuar fatura të tilla pa përshkrim adekuat dhe të ndërpres menjëherë furnizimet me naftë përmes KRM-ve. Furnizimet me naftë të bëhen vetëm nga operatori ekonomik që ka licencë për këtë lloj furnizimi duke u bazuar në kontratë valide.

---

**Çështja A10 - Mos plotësimi i planit për menaxhim të kontratës për punët e kryera**

- Gjetja** Sipas nenit 81 të LPP, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të përgatisin planin për menaxhim të kontratës. Plani i Menaxhimit të Kontratës (më tutje PMK) është dokument i cili do të përditësohet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Në projektin “Riparimi i infrastrukturës së deponive të KMDK-së” nga shtatë (7) situacionet e pranuar kemi vërejtur se në dy prej tyre (në fund të vitit) plani për menaxhimin e kontratës nuk ishte plotësuar nga menaxheri i kontratës me qëllim të raportimit për punët e kryera. Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk e kishte vlerësuar të nevojshme raportimin e këtyre dy situacioneve të pranuar me arsyen se projekti është ende në vazhdim.
- Rreziku** Mos raportimi për punët e kryera nga menaxheri i kontratës sipas kërkesave të LPP, nuk jep informata të plota për vlefshmërinë e vlerës së paguar dhe obligimeve të mbetura të Kompanisë për punët në proces.
- Rekomandimi A10** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se menaxheri i kontratës monitoron punën dhe harton raporte lidhur me ecurinë e punës për secilin situacion të pranuar me qëllim të evidentimit të dobësive në proces dhe evitimit të pagesave për punët e papërfunduara.

### 3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të kompanisë, ekuiteti është prezantuar sipas kësaj strukture:

**Tabela 4: Ekuitei i Kompanisë më 31.12.2018**

(në €)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>KAPITALI</b>	<b>1,512,621</b>	<b>1,375,606</b>
Kapitali themelor	25,000	25,000
Kapitali rezervë	1,440,299	1,440,299
Fitimet/Humbjet e mbajtura	(89,693)	(277,041)
Fitimet/Humbjet e vitit	137,015	187,348

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve operative, investuese dhe atyre financuese. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme (në €)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Arkëtimet nga blerësit	2,125,366	1,953,226
Arkëtimet tjera	63,341	110
Pagesat për furnitorët	(759,795)	(820,087)
Pagesa për te punësuarit	(715,730)	(673,706)
Pagesa për interes	(7,934)	(969)
Pagesa për tatime	(176,317)	(108,537)
Pagesa tjera	(58,170)	(57,898)
<b>Rrjedha neto nga aktivitetet operative</b>	<b>470,761</b>	<b>292,139</b>
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</i>		
Arkëtimet nga shija e pajisjeve	0	0
Pagesa për blerjen e pajisjeve	(523,081)	(394,132)
<b>Paratë neto nga aktivitetet investive</b>	<b>(523,081)</b>	<b>(394,132)</b>
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimi nga mbështetja e aksionarit	0	114,583
Pagesa e dividendës	0	0
<b>Paratë neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>0</b>	<b>114,583</b>
<b>Rritja e parasë gjate vitit</b>	<b>(52,320)</b>	<b>12,590</b>
Paraja në fillim të vitit	67,655	55,065
<b>Paraja në fund të vitit</b>	<b>15,335</b>	<b>67,655</b>

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



---

## 3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

---

### Çështja A11 - Shënimet shpjeguese jo të mjaftueshme

**Gjetja** Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë i pasqyrave financiare duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Gjatë auditimit, kemi vërejtur se disa zëra të prezantuar në pasqyrat financiare nuk janë shpalosur dhe nuk korrespondojnë me referencën përkatëse. Në vijim po paraqesim mangësitë e shënimeve shpjeguese:

Tek pasqyra e të ardhurave është dhënë referenca 11.2 për të hyrat tjera e cila nuk është shpalosur në shënimet shpjeguese. Shpenzimet e kamatës me reference 12.7 nuk është shpalosur në shënimet shpjeguese. Në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ishte dhënë referenca me numër 17 deri sa në shënimet shpjeguese nuk ka referencë me numër 17. Për më tepër, shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacion të detajuar lidhur me pasurinë kapitale dhe jo kapitale të përfituar gjatë vitit 2018. Kjo ka ndodhur për shkak të mos kujdesit të duhur gjatë përpilimit dhe rishikimit të shënimeve shpjeguese.

**Rreziku** Duke pasur parasysh se shënimet shpjeguese bëhen për të dhënë një kuptim më të plotë të të gjitha pasqyrave financiare, mungesa e informatave apo mos korrespondenca në mes tyre paraqesin një paqartësi tek përdoruesit e jashtëm të pasqyrave financiare dhe aksionari.

**Rekomandimi A11** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënimet shpjeguese prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit. Për më tepër, ato nuk duhet të miratohen pa një rishikim të hollësishëm të të gjithë zërave të pasqyrave financiare dhe korrespondencave përkatëse të këtyre zërave në shënime shpjeguese.

## 4 Qeverisja e mirë

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KMDK ka shënuar progres të dukshëm në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA në vitet paraprake dhe rrjedhimisht ka përmirësuar një pjesë të konsiderueshme të qeverisjes. Është shënuar progres në forcimin e kontrolleve të brendshme përmes raportimit menaxherial dhe llogaridhënies më efektive. Përkundër progresit të arritur, ka ende fusha të qeverisjes të cilat kërkojnë vëmendjen e menaxhmentit dhe marrjen e masave për veprim. Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet funksionalizimit të komisionit të auditimit të brendshëm dhe kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e rreziqeve të cilat mund ta pengojnë Kompaninë në arritjen e objektivave.

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një stafit i cili njëkohësisht është Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet tjera të kompanisë dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit. NJAB kishte përgatitur planin vjetor dhe strategjik për vitin 2018, mirëpo të njejtat nuk ishin të protokolluar. Më tutje, fushat e planifikuara për auditim ishin kryesisht për shpenzime, prokurim, personel, pasuri dhe donacione nga qeveria. Përmes këtyre raporteve NJAB do duhej ti ofronte menaxhmentit informata lidhur me funksionimin e kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre. Komiteti i auditimit kishte mbajtur takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar të gjitha raportet e NJAB.

### Çështja B1 - Funksionimi i NJAB-së jo i mjaftueshëm për t'i kontribuar forcimit të kontrolleve të brendshme

**Gjetja** NJAB për vitin 2018 kishte planifikuar shtatë (7) auditime dhe një (1) auditim sipas kërkesës, mirëpo nuk kishte përcaktuar afatet kohore për kryerjen e secilit auditim. Gjatë vitit 2018 NJAB kishte kryer pesë (5) raporte të cilat nuk përmbajnë gjetje dhe rekomandime për menaxhmentin me qëllim të përmirësimit të kontrolleve të brendshme, por vetëm analiza mbi shpenzimet, të hyrat dhe projektet e caktuara të prezantuara në raportet tremujore për vitin 2018. Më tutje, raportet nuk ishin të protokolluara dhe për raportet e përfunduara nuk kishte dosje të auditimit për t'i mbështetur me dëshmi. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së vëmendjes së menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit nga puna e auditimit të brendshëm.

**Rreziku** Mungesa e rekomandimeve dhe mos dokumentimi i punës së raporteve të Auditimit të Brendshëm, rrisin rrezikun që NJAB të mos jetë efektive dhe të mos ndihmojë Kompaninë në forcimin e kontrolleve të brendshme.

**Rekomandimi B1** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se NJAB kryen funksionin e vet në përputhje me kërkesat ligjore të fushës së auditimit të brendshëm. Raportet e NJAB duhet të përmbajnë rekomandime për mangësitë e identifikuara dhe të planifikohen duke u bazuar në fushat me rrezik.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë kompaninë.

---

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

## **Çështja B2 – Kontrollat për menaxhimin e rrezikut jo të mjaftueshme**

**Gjetja** Sipas Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave të ndërmarrjeve publike, bordi i drejtoreve duhet t'i rishikoj rreziqet kryesore në biznes, të sigurohet që janë të vendosura menaxhimi i rrezikut dhe kontrolli dhe t'i rishikoj në baza të rregullta duke u bazuar në ndryshimet dhe objektivat strategjike të Ndërmarrjes. Kompania përballat me shume rreziqe si të natyrës financiare, operative, teknologjisë së vjetërsuar, kostos së lartë të shërbimeve, tarifave të ulëta për shërbimet e kryera dhe rreziqe të jashtme në atë të infrastrukturës, ndotjes dhe kontaminimit të mjedisit etj. Deri në përfundim të auditimit nuk kemi pranuar ndonjë dokument për listën e rreziqeve potenciale që mund t'i ndodhin kompanisë dhe mënyrën e reagimit ndaj tyre. Kjo për shkak të nënvlerësimit të tyre dhe mungesës së fondeve. Megjithatë kompania në plan të biznesit ka planifikuar shumën 52,000€ për shpenzime të pa parashikuara (si: administrative, ndëshkime, gjyqësore, operative dhe raste emergjente), për qëllime të mbulimit të këtyre rreziqeve.

**Rreziku** Mungesa e një regjistri të dokumentuar të rreziqeve mund të ketë ndikim që menaxhmenti të mos identifikoj dhe të menaxhoj rreziqet e në këtë kontekst edhe mos arritjen e objektivave strategjike të saj. Shuma e ndarë për shpenzime të pa parashikuara paraqet një shumë të ulët në raport me rreziqet që kompania mund të ballafaqohet nga aktiviteti i saj.

**Rekomandimi B2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se do të ndërmerren hapa në këtë drejtim dhe do të formoj komision për hartimin e një liste me të gjitha rreziqet e mundshme e cila do të shfrytëzohet si mjet për parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve në nivele sa më të ulëta. Kjo do të kontribuoj efektivitetit më të lartë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjithashtu të ndaj një provizion/fond të mjaftueshëm për mbulimin e dëmeve të mundshme të shkaktuara ndaj ambientit.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të KMDK-së ka rezultuar në 11 rekomandime kryesore. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, një (1) ishin në proces të zbatimit dhe tri (3) ishin të pa zbatuara ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit, dhe të merren të gjitha veprimet që çështjet që kanë ndikuar modifikimin e opinionit të korigjohen dhe të mos përsëriten. Gjithashtu Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga ZKA dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen Bordit Drejtues.	Menaxhmenti ka ndërmarrë hapa për çështjet e ngritura në raportin e vitit të kaluar. Kjo ka ndodhur pasi pagesat ndaj ATK-se do bëhen në bazë të marrëveshjes.	Rekomandimi lidhur me gjendjen e obligimeve ndaj ATK-se është zbatuar, derisa dy çështjet tjera nuk janë zbatuar ende, të cilat nuk janë në kompetencë të tyre, por të aksionarit-MZHE-se.
2	Plani i biznesit (të hyrat dhe shpenzimet)	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që gjatë hartimit të planit të biznesit përfshin të gjitha aktivitetet e saj që mund të ndodhin gjatë vitit.	Është rishikuar plani fillestar që të reflektojnë	Po, është zbatuar.

			ndryshimet e duhura.	
3		Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme për t'i paguar obligimet ndaj punëtorëve për pagesën e shtesës së parës në punë.	Është marrë parasysh ky rekomandim nga menaxhmenti	Po, është zbatuar.
4	Pasqyra e pozitës financiare (Balanci i gjendjes)	Kryesuesi i Bordit duhet që brenda një afatit sa më të shkurtër të hartoj një rregullore të brendshme mbi menaxhimin e pasurive, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat për përdorimin e pasurive (të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit).	Bordi i drejtoreve ka hartuar Rregulloren për menaxhimin e pasurive.	Po, është zbatuar.
5	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se mbeturinat e deponuara regjistrohen sipas llojit dhe kategorizimit të tyre. Gjithashtu, të forcoj kontrollet e brendshme për të eliminuar gabimet në klasifikim të tyre sipas llojeve.	Menaxhmenti ka marrë veprime për mos përsëritjen e gabimeve të tilla.	Po, është zbatuar.
6		Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë të gjitha veprimet për forcimin e kontrolleve të brendshme për të bërë një vlerësim dhe planifikim të nevojave të kompanisë dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, për të shmangur ndarjen e kontratave të blerjeve të njëjta në disa sosh.	Menaxhmenti ka marrë parasysh këtë rekomandim	Po, është zbatuar.
7	Trajtimi i shënimeve shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve në shënimet shpjeguese të prezantohen informacione të detajuara dhe të plota për secilin zë të PFV.	Menaxhmenti ka marrë parasysh rekomandimin, por ende i kanë mbete çështje të pa trajtuara.	Jo, nuk është zbatuar.
8	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që ka ndërmarr veprime konkrete për zbatimin e plotë të të gjitha rekomandimeve të auditimit të vitit të 2016 dhe atij 2015.	Menaxhmenti ka marrë parasysh këtë rekomandim	Po, pasi shumica janë zbatuar.

9	Sistemi i auditimit te brendshëm	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj së është arritur përfitimi maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të sigurojë funksionimin adekuat të NJAB-së, duke rishikuar në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik, ofrojnë siguri dhe raportim cilësor për menaxhmentin. Po ashtu, të sigurojë se NJAB ka përgatitur dosjen e auditimit për të vërtetuar se të gjeturat janë mbështetur me dëshmi.	Menaxhmenti nuk ka marrë parasysh këtë rekomandim.	Jo, nuk është zbatuar.
10	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është hartuar plani për menaxhimin e rreziqeve si operative dhe financiare, të vlerësoj ndikimin e tyre në rast se ato ndodhin, të përcaktoj masat parandaluese ndaj tyre, si dhe të ndaj një provizion të mjaftueshëm për mbulimin e dëmeve të mundshme të shkaktuara ndaj ambientit.	Menaxhmenti ende nuk e ka marrë parasysh këtë rekomandim.	Jo, nuk është zbatuar.
11	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që procesi i përgatitjes së raporteve tremujore të jetë dizajnuar në atë formë që të ketë një përmbajtje të plotë të kërkesave ligjore dhe vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe cilësinë e tyre, të miratohen nga BD.	Menaxhmenti ka marrë parasysh këtë rekomandim.	Po, është zbatuar.
	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018 (këtu vendosen te gjitha rekomandimet e dhëna për vitin 2018)		
1	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se shënimet shpjeguese përfshijnë sqarimet e nevojshme lidhur me të hyrat e prezantuara në pasqyrën e të ardhurave dhe mbi bazën e kalkulimit të tatimit në fitim.		
2	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të marrë masat e nevojshme për sigurimin e licencës për kryerjen e aktiviteteve të saj primare.		
3	PFV	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se ka bërë përpjekjet maksimale për të siguruar tariforen e re për deponimin e mbeturinave në mënyrë që të shmangen aplikimet e tarifave pa bazë ligjore.		

4	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një rishqyrtim për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes në Opinion dhe do të marrë masat e nevojshme për eliminimin e tyre. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.
5	Plani i biznesit	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e rishikimit të planit të biznesit, të bëhen analiza më të sakta lidhur me të hyrat dhe aktivitet investuese. Po ashtu të siguroj se për projektet kapitale të planifikuara, të merrem parasysh burimet e sigurta të financimit.
6	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroi që zyra e financave bën regjistrimin e të gjitha transaksioneve në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit, dhe të siguroj se është bërë prerja/regjistrimi i shpenzimeve apo të hyrave të cilat i takojnë vetëm periudhës kontabël.
7	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit të siguroj që përzgjedhja dhe rekrutimi i kandidatëve të bëhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e rekrutimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara për përsëritje të konkursit dhe respektim të Udhëzimit Administrativ. Gjithashtu të siguroj se caktimi dhe zbatimi i kriterëve ka për qëllim rekrutim transparent të kandidateve duke u bazuar në parimin e meritës dhe kualifikimeve përkatëse për pozitën e caktuar.
8	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se nuk do të merren vendime të cilat nuk janë të ligjshme dhe në pajtim me vendimet e aksionarit. Vendimet e aksionarit duhet të merren parasysh, të vlerësohen dhe të kuptohen si të zbatueshme, ndërsa në rast të paqartësive të kërkohet sqarimi nga Aksionari.
9	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se tatimet dhe kontributet ndaj ATK-së do të paguhen në afatin e caktuar me ligj dhe mos të lejojnë vonesa të cilat shkaktojnë detyrime shtesë për ndëshkime dhe interesa, duke e dëmtuar buxhetin e kompanisë.
10	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se furnizimi me naftë bëhet vetëm me Operatorin Ekonomik të kontraktuar dhe që ka licencë për shitjen e naftës. Po ashtu duhet të siguroj se zyrtarët financiar mbajnë evidencë dhe raportojnë/shpalosin të gjitha obligimet për të cilat janë pranuar shërbimet apo furnizimet edhe atëherë kur fatura ende nuk ka arritur për ekzekutim.
11	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës përse janë pranuar fatura të tilla pa përshkrim adekuat dhe të ndërpres menjëherë furnizimet me naftë përmes KRM-ve. Furnizimet me naftë të bëhen vetëm nga operatori ekonomik që ka licencë për këtë lloj furnizimi duke u bazuar në kontratë valide.



12	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se menaxheri i kontratës monitoron punën dhe harton raporte lidhur me ecurinë e punës për secilin situacion të pranuar me qëllim të evidentimit të dobësive në proces dhe evitimit të pagesave për punët e papërfunduara.
13	Trajtimi i shënimeve shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënime shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit. Për më tepër, ato nuk duhet të miratohen pa një rishikim të hollësishëm të të gjithë zërave të pasqyrave financiare dhe korrespondencave përkatëse të këtyre zërave në shënime shpjeguese.
14	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se NJAB kryen funksionin e vet në përputhje me kërkesat ligjore të fushës së auditimit të brendshëm. Raportet e NJAB duhet të përmbajnë rekomandime për mangësitë e identifikuara dhe të planifikohen duke u bazuar në fushat me rrezik.
15	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se do të ndërmerren hapa në këtë drejtim dhe do të formoj komision për hartimin e një liste me të gjitha rreziqet e mundshme e cila do të shfrytëzohet si mjet për parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve në nivele sa më të ulët. Kjo do të kontribuoj efektivitetit më të lartë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjithashtu të ndaj një provizion/fond të mjaftueshëm për mbulimin e dëmeve të mundshme të shkaktuara ndaj ambientit.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e NP-së në rast të mospajtitimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja 6	Jo	E drejta e Kompensimit për stimulimin e performancës (Bonuse) të Bordit të Drejtoveve, është e drejtë ligjore dhe e përcaktuar qartë me <i>nenin 12 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe me nenin 29.4 të Kodit të Etikes dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike</i> . Kurse, pagesa e bonuseve të Drejtoveve të KMDK-se është bërë në respektim të plotë të ligjeve në fuqi dhe procedurave të kërkuara edhe sipas Vendimit të Ministrit të MZHE-së. Fillimisht Komisioni i Auditimit me datë 24 Maj 2018 në respektim të plotë të nenit 20.4 të <i>Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike</i> , ka përgatitur dhe miratuar Deklaratën e Politikës së Kompensimit për Drejtoret dhe Zyrtaret e NP-së, ku kjo Deklaratë e thotë qartë se do implementohet vetëm pas finalizimit të Raportit të Auditorit të Jashtëm. Në këtë Deklaratë me datë 28 Maj 2018 ia kemi dërguar Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP-MZHE). E cila Njësi si përfaqësuese e Aksionarit nuk ka reaguar me asnjë shkresë. Kurse me datë 11/06/2018, Bordi ka shqyrtuar Raportin e Auditorit të Jashtëm (ZKA) për vitin 2017 dhe e ka miratuar këtë raport, poashtu konforme rezultateve financiare për vitin 2017 që ishin rezultate me bilanc pozitiv, dhe konforme Deklaratës së Politikës së Kompensimit ka marr vendim për ndarjen e Bonuseve dhe po atë ditë me datë 11/06/2018 këto vendime ne i kemi përcjell prapë NJPMNP-MZHE dhe nuk kemi pasur asnjë vërejtje apo kundërshtim lidhur me mosrespektimin e vendimit të Aksionarit.	Kompania vetëm ka përshkruar nenet e ligjit dhe procesin e ndarjes dhe aprovimit të Bonuseve për BD, por vendimi nr. 01/2599 i datës 18.12.2017, i nxjerr nga aksionari (Ministri i Zhvillimit Ekonomik) ka qenë i qartë ku në pikën 1 shkruan "Pezullimin e vendimeve për kompensim për stimulimin e efektshmërisë së anëtarëve të bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike qendrore. Andaj gjetja dhe rekomandimi i auditorit qëndron.
Çështja 8	Jo	Furnizimi nga KRM Pastërtia SH.A, me marrëveshje mirëkuptimi kishte ka ndodhur për arsye se 8 herë kemi <b>rishpallur</b> tenderin për furnizim me derivate të naftës në atë periudhë.	Kompania ka dhënë vetëm arsyetime duke e pohuar gjendjen e konstatuar, andaj gjetja dhe rekomandimi i auditorit qëndron.

Çështja 9	Jo	<p>KMDK SH.A me kërkesë nga auditori, i kemi prezantuar arsyet e furnizimit me derivate të naftës nga Eco-Higjiena Gjilan duke pas parasysh që procesi i tenderimit ka qenë i tej zgjatur nga OSHP-ja, meqë veprimtaria e KMDK-së është mjaft e ndjeshme për mjedisin kemi qenë të detyruar të bëjmë furnizim të përkohshëm deri në marrjen e Vendimit nga OSHP-ja. Ne i kemi ofruar dëshmi auditorit me dt. 06 maj 2019 dy dokumente edhe atë:</p> <p>Ankesa nga ofertuesi Petrol Company me seli në Fushë Kosovë dhe</p> <p>Vendimi i OSHP përkatësisht panelit shqyrtues nr.538/18 datë 07.02.2018.</p>	<p>Kompania ka dhënë vetëm arsyetime duke e pohuar gjendjen e konstatuar, andaj gjetja dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>
Çështja 13		<p>Rreziqet dhe Sfidat kryesore, janë të paraqitura dhe planifikuara në vija të trasha përmes Planit të Biznesit dhe të zbrërthyer në Planin Vjetor Operativ të Punës për çdo vit, krahas kësaj edhe Plani i Veprimit për secilën deponi (dokumenti Plani Operativ i Punës për vitin 2018): -Gjendja dhe niveli me ujërat të zeza në DS Mirash është e rëndë, për shkak të mos trajtimit të tyre (problem i trashëguar ndër vite),- Jetëgjatësia e kufizuar e deponive; - Makinaria e rëndë e vjetërsuara në të gjitha DS dhe STF, shkalla shumë e lartë e amortizimit (defektet e shpeshta); -Mungesa e sasisë së dheut për mbulimin e mbeturinave sipas standardeve; -Vështirësitë në furnizime nga OE (derivate, riparim dhe mirëmbajtje, shërbime);</p> <p>Sfidat tjera të përgjithshme (financiare dhe operative): -Rritja e inkasimit dhe tarifa tepër e ulët e trajtimit të mbeturinave për ton, -Vonesa në caktimin dhe ngritjen e Tarifës së re, e propozuar nga KMDK ndër vite, -Mbledhja e borxheve, -Operimi nëpër DS me asete të amortizuara, -Trajtimi i ujërave të zeza dhe zvogëlimi i ndotjes, -Mos trajtimi i ujërave të zeza sidomos në DS Mirash, -Prezenca e personave të tretë fizik-ilegal gjatë operimit në DS Velekincë, -Mundësia e shfaqjes së zjarreve, -Eksplodimi i deponive nga gazrat e grumbulluara, -Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.</p>	<p>Kompania me komentimin e vet i ka numëruar shumicën e rreziqeve dhe shaktaret e tyre, duke e pohuara gjendjen e konstatuar, andaj gjetja dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>